



Në bazë të nenit 13.8 të Ligjit nr. 2003/14, për planifikim hapësinor dhe Ligjit nr. 03/L - 106, për ndryshimin e Ligjit për planifikim hapësinor, të nenit 17, shkronja **b** të Ligjit nr. 03 L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008) dhe të nenit 16, pika 16.1, shkronja **b** të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.3.2010, merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E PLANIT RREGULLUES
TË LAGJES "MATI 1" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Planit rregullues të lagjes "Mati 1" në Prishtinë, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-35-18186, të dt. 3.8.2005.

Ndryshimet dhe plotësimet e Planit, nga par. 1 i këtij neni, përbëhen nga pjesa tekstuale dhe ajo grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Plani rregullues i lagjes "Mati 1" i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01nr. 35-18186, të dt. 3.8.2005, ndryshohet dhe plotësohet në pjesët e përshkruara si më poshtë:

- Është riformësuar dhe është punuar projekti kryesor për rrugën e planifikuar "B", në bazë të gjendjes ekzistuese në terren. Kjo rrugë nga $d = 25.1$ m sa ka qenë e paraparë të ketë trasenë e shtrirjes në planin rregullues, tashmë është planifikuar të jetë $d=39.75$ m gjerësi, ku përfshihen nga 3 korsi për qarkullim të automjeteve, në të dy drejtimet, ishulli i gjelbëruar në mes të dy drejtimeve, shtigjet e gjelbëruara në të dy anët, trotualet dhe kanali i hapur për ujin atmosferik. Janë paraparë 3 rrethrotullime përgjatë kësaj rruge: në kryqëzimin me rrugën "Muharrem Fejza", në vazhdim me rrugën "Enver Maloku" dhe në kryqëzimin me rrugën "Isa Kastrati";
- Është riformësuar dhe është punuar projekti kryesor për një pjesë të rrugës së planifikuar "C" ("Enver Maloku"), në bazë të gjendjes ekzistuese në terren. Traseja e saj ka kaluar nga $d=34.2$ m në $d=33.2$ m, ku përfshihen nga 3 korsi për

- qarkullim të automjeteve, në të dy drejtimet, ishulli i gjelbëruar në mes të dy drejtimeve, shtigjet e gjelbëruara në të dy anët dhe trotuaret;
- Rruga e planifikuar "E" dhe rruga e planifikuar "D", janë zhvendosur në pjesën më jugore të lagjes, me arsyetimin që të mundësohet shfrytëzimi i tyre si nga banorët e lagjes "Mati 1", po ashtu edhe nga banorët e lagjes "Mati 2". Në kryqëzimin e rrugëve të planifikuara "C", "E" dhe "D" është paraparë një rrethrotullim. Në pozicionin ku ka qenë rruga e planifikuar "E", është lënë një rrugë me gjerësi $d=14m$, në mënyrë që të mundësojë qarkullimin sa më të lehtë e më të shpejtë të banorëve të asaj pjese;
 - Rruga "Muharrem Fejza" është vazhduar deri te rrethrotullimi, duke e përcjellë trasenë e rrugës ekzistuese;
 - Rruga e tretë, që lidhë rrugën e planifikuar "A" me rrugën "Muharrem Fejza", pas kërkesës së banorëve të lagjes dhe shqyrtimeve tona, ka kaluar nga $d=14m$ në $d=7.5m$;
 - Rruga që është paralel me rrugën "Muharrem Fejza" dhe lidh atë me rrugën e planifikuar "C", tashmë është zgjatur dhe shkon përgjatë gjelbërimit, duke formuar në pjesën jugore të saj një udhëkryq me rrugën e planifikuar "C" dhe rrugën "Shaqir Igrisha";
 - Rruga "Shaqir Igrisha" nga kryqëzimi me rrugën "Ndue Përllëshi", vazhdon përgjatë rrugës ekzistuese deri në rrugën kryesore të planifikuar "B", vazhdon në pjesën jugore përgjatë rrugës ekzistuese deri në kryqëzimin me rrugën e planifikuar "C";
 - Rruga që ka qenë paralel me rrugën "Shaqir Igrisha", afër varrezave, tashmë është hequr për shkak të afërsisë së dy rrugëve;
 - Rruga e planifikuar "H" pothuajse është e njëjtë si në Planin rregullues, përveç pjesës së fundit ku lidhet me rrugën e planifikuar "C", që e përcjellë rrugën ekzistuese, me zgjerim proporcional në të dy anët;
 - Rruga e planifikuar "F" është riformësuar, varësisht nga gjendja ekzistuese dhe duke i përcjellë izohipsat e terrenit;
 - Për pjesën në mes të rrugëve të planifikuara "G" dhe "F", është bërë një plan detal për mënyrën e organizimit të objekteve dhe funksionimit të lagjes si tërësi, prandaj edhe rrugët e brendshme i janë përshtatur pozicionimit të objekteve;
 - Pjesa në anën veriore të rrugës së planifikuar "F", mbetet kryesisht e njëjtë si në planin rregullues të Matit;
 - Koeficienti i shputës (SOI) është kufizuar për të gjithë zonën në 0,6 dhe me këtë është rritur pjesa për gjelbërim brenda ngastrave;
 - Është reduktuar, në pjese të caktuara, hapësira publike për gjelbërimin, duke u zëvendësuar me rritjen e sipërfaqes gjelbëruese brenda ngastrave ndërtimore;
 - Për numrin e banorëve, të paraparë rreth 30.000 (prej 25.000 deri 35.000), është planifikuar hapësira gjelbëruese rreth $23m^2$ për një banor (në Bashkimin Evropian është rreth $11m^2$), kurse hapësira e gjelbëruar brenda kësaj lagjeje do të jete rreth $25m^2$ për një banor (Organizata Botërore e Shëndetësisë preferon mbi $12m^2$ hapësirë të gjelbëruar);

Neni 3

Ndryshimet dhe plotësimet e Planit rregullues "Mati 1", të përshkruara në nenin 2 të këtij Vendimi, janë të paraqitura edhe në mënyrën grafike, të cilat do të jenë pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 4

Realizimi dhe rregullimi i hapësirës së përfshirë brenda kufijve të Planit rregullues "Mati 1", me ndryshimet dhe plotësimet sipas këtij Vendimi, do të bëhet sipas kushteve urbanistike - teknike të përcaktuara me lejet urbanistike nga organi kompetent komunal për punë të planifikimit dhe urbanizmit.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, të cilat do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. Nr. 35-642, më 01.04.2010

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti ecc. i dip.